



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____ 2024

PËR

**NJË SHITESË DHE DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 60/2023 “PËR
TRAJTIMIN E VEÇANTË TË STUDENTËVE QË NDJEKIN
PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
“MJEKËSI E PËRGJITHSHME” NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 1, pas fjalëve “...për trajtimin e studentëve...” shtohen fjalët “... shtetas shqiptar...”.

Neni 2

Në nenin 4, të bëhen ndryshimet si vijon:

- Në pikën 1, shkronja “b” fjalët “5 (pesë) vjet” të zëvendësohen me fjalët “3 (tre) vjet”.
- Në pikën 1, shkronja “c”, me fjalët “5-vjeçar” të zëvendësohen me fjalët “3-vjeçar”.

3. Në pikën 2, shkronja “a”, fjalët “3 (tre) vjet” të zëvendësohen me fjalët “2 (dy) vjet”.
4. Në pikën 2, shkronja “b”, fjalët “3-vjeçar” të zëvendësohen me “2-vjeçar”.
5. Në pikën 3, shkronja “a”, fjalët “2 (dy) vjet” të zëvendësohen me fjalët “1 (një) vit”.
6. Në pikën 3, shkronja “b”, fjalët “2-vjeçar” të zëvendësohen me fjalët “1-vjeçar”.

Neni 3

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6 Punësimi

1. Për studentin që përfundon programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe ka nënshkruar marrëveshje sipas përcaktimeve të këtij ligji, në momentin e lindjes së të drejtës për punësimin e tij, ndiqen procedurat e mëposhtme:
 - a) punësohet në institucionet shëndetësore sipas nevojave për mjekë të shpallura nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe përzgjedhja e vendeve të punës bëhet nga mjeku i licensuar, në bazë të renditjes sipas notës mesatare të përfundimit të studimeve;
 - b) koha e kryerjes së procedurës për punësimin e mjekut nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, është brenda 3 (tre) muajve nga momenti i lindjes së të drejtës për punësim.
2. Në rastet kur punësimi nuk realizohet brenda 3 (tre) muajve, për shkaqe që nuk varen nga mjeku, deri në krijimin e mundësisë për punësim në institucionet shëndetësore publike, për një periudhë deri në 9 (nëntë) muaj, mjekut i lind e drejta të trajtohet me 80% të pagës së mjekut të përgjithshëm në kujdesin parësor, për një periudhë jo më të gjatë se ky afat, ose të zgjedhë të punësohet në institucionet shëndetësore jo publike në vend, duke njoftuar ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, si dhe duke ruajtur të drejtën për punësim prioritar brenda periudhës 9 (nëntë) mujore në institucionet shëndetësore publike.
3. Periudhat sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, përfshihen brenda afateve të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji kur mjeku punësohet, në rast të kundërt pas përfundimit të tyre, konsiderohet i përmbushur detyrimi sipas

përcaktimeve të këtij ligji dhe mjeku ka të drejtën të pajiset me diplomën përkatëse universitare.

4. Mënyra dhe procedura e punësimit me prioritet përcaktohet më udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për arsimin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Ky ligj i shtrin efektet në periudhën nga viti akademik 2024-2025 deri në vitin akademik 2028-2029.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

LINDITA NIKOLLA